

Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_725_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërithme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-666-2014 dt. 21 nëntor 2014 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "ENERGY FIRST - ONE" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Wind Park -Bajgora me kapacitet të instaluar prej 34.25 MW, në lokacionin Selac, komuna e Mitrovicës, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Wind Park – Bajgora, me kapacitet të instaluar prej 34.25 MW, në lokacionin Selac, komuna e Mitrovicës, të datës 06.02.2015 të shoqërisë "ENERGY FIRST - ONE " SH.P.K., me adresë: rruga "Garibaldi",nr. 4/14 – 10000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "ENERGY FIRST - ONE" SH.P.K., dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Wind Park – Bajgora, me kapacitet të instaluar prej 34.25 MW, në lokacionin Selac, komuna e Mitrovicës.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërithme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.

Arsyetim



- ZRRE me datë 06.02.2015 nga shoqëria “ENERGY FIRST - ONE“ SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Wind Park – Bajgora, me kapacitet të instaluar prej 34.25 MW, në lokacionin Selac, komuna e Mitrovicës.
- Bordi i ZRRE-së me datë 21 nëntor 2014, shoqërisë “ENERGY FIST - ONE“ SH.P.K, i ka lëshuar Vendimin V-666-2014 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-666-2014 dt. 21 nëntor 2014 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, shoqërisë “ENERGY FIRST - ONE“ SH.P.K, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në pajtim me legjislacionin në fuqi.


V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar